



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 38
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303
Prishtinë, më 20 Mars 2019, në orën 11:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Drita Millaku, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Bekim Haxhiu, Flora Brovina dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Miljana Nikoliq dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës tjerë: Shpëtim Kadriu – KDI, Drenushë Maxhuni – Koha Ditore, Fazli Veliu – RTK, Arbisa Shefkiu – Kallxo.com, Besiana Dauti – Ekonomia Online, Vaide Morina – Radio Kosova, Ervin Ibrahim, UNKT dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi: Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

RENDI I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 13.2.2019 dhe 15.2.2019;**
- 3. Diskutim i informatës së drejtorit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikës Universitare të Kosovës, lidhur me gripin sezonal në Kosovë;**
- 4. Informata rreth themelimit të Këshillit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm;**
- 5. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 13.2.2019 dhe 15.2.2019;

Procesverbali i mbledhjes së datës 13.2.2019 dhe 15.2.2019, u miratua pa asnjë ndryshim.

3.Diskutim i informatës së drejtorit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikës Universitare të Kosovës, lidhur me gripin sezonal në Kosovë;

Besa Baftiu, kryetare, tha se më 8 mars ia ka dërguar një shkresë drejtorit të SHSKUK-së në emër të Komisionit lidhur me situatën epidemiologjike të gripit sezonal, i cili është paraqitur në Kosovë. Ajo po ashtu theksoi se në Kosovë nga ky grip kanë humbur jetën 13 qytetarë. Sipas saj, shpallja e epidemisë është e vonuar, duke pasur parasysh se pas 11 rasteve që kanë humbur jetën, atëherë është shpallë epidemia në nivel vendi, ku fatkeqësisht në këto 13 raste ka humbur jetën edhe një infermier i moshës së re. Në bazë të informatës të cilën e ka dërguar drejtori i SHSKUK-së, Dr.Basri Sejdiu, vërejmë se të gjitha rastet që janë paraqitur kanë qenë të pavaksinuar, pra nuk e kanë marrë vaksinën e gripit. Baftiu theksoi se Tamiflu-ja që është bar antiviral, që deri në vitet paraprake është dhënë tek pacientët, këtë vit nuk është dhënë edhe pse është një bar shumë i rëndësishëm në fazën e parë, gjegjësisht 48 apo 72 orët e para, ku virusi nuk qarkullon në infraqelizë. Nuk ka pasur vaksina të mjaftueshme, gjithsej kanë qenë 80.000-100.000 doza. Sipas kryetares vaksinat duhet t'i marrin grupet të cilat janë të rrezikuara nga gripin, mirëpo, në këtë rast, të rrezikuar kanë qenë edhe punëtorët shëndetësorë.

Ajo rekomandoi, se në momentin kur të jepen vaksinat, duhet të ketë doza të mjaftueshme, në mënyrë që i gjithë personeli mjekësorë të vaksinohet dhe të evitohen fatkeqësitë. Grupet e rrezikuara nga gripin janë personat të cilët kanë sëmundje kronike dhe ata të cilët janë në moshë dhe është periudha e caktuar se kur duhet të jepen vaksinat, mirëpo, vet fakti që ka pasur shumë raste, ka ndikuar që të shpallet gjendje epidemie. Ajo tha, se në bazë të informatës së pranuar, del që situata me gripin endemik është nën kontroll.

Haxhi Avdyli, tha se situata aktuale me gripin tregon se sa i brishtë është sistemi ynë shëndetësor dhe në të njëjtën kohë tregon edhe se sa të dobët janë menaxherët e sistemit shëndetësor. Sipas tij, udhëheqësit e këtij sektori janë të papërgjegjshëm dhe të padijshëm. Ai vlerësoi se mobilizimi për gripin ka qenë skandaloz, ku sipas tij ka qenë një mobilizim i vonshëm, përderisa gripin ka eskaluar. Institucionet shëndetësore në Kosovë nuk paguhën vetëm për të shëruar, mirëpo edhe për të parandaluar epideminë të ndryshme, e në këtë rast, masat parandaluese nuk kanë ekzistuar. Ai e konsideron si dështim sistemin shëndetësor në këtë vit dhe shpreson që ky vit të jetë shembull dhe mësim për vitet e ardhshme.

Sipas tij kanë dështuar edhe mediat, të cilat nuk janë marrë me këto raste vdekjesh të cilat kanë mundur të parandalohen. Ajo që duhet cekur së pari, është mungesa e informatës së duhur tek qytetarët, nuk ka pasur mobilizim me vaksina dhe Tamiflu. Sipas tij raporti i cili është dorëzuar në Komision është qesharak dhe tregon edhe gjendjen e sistemit shëndetësor. Ai tha, se Komisioni duhet ti dërgojë vërejtje të gjithë aktorëve të duhur, duke përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë, Institutin Kombëtar, sepse si Komision jemi zëri i qytetarëve. Ai po ashtu, mendon

se ka më shumë raste të cilat nuk janë raportuar, pra vdekjet të cilat ndodhin në shtëpi, vdekjet e padiagnostifikuara. Mesazhi i tij është që institucionet të përgatiten për vitin e ardhshëm, duke u pajisur me doza të mjaftueshme të vaksinave dhe Tamiflu-së. Këtë vit stoqet e Tamiflu-së në institucionet shëndetësore farmaceutike kanë qenë zero, për dallim nga vitet e kaluara. Ai tha se duhet të merret mësim për vitet e ardhshme dhe duhet që parandalimi i gripit të bëhet në mënyrë që të mos kemi raste të tilla.

Besa Baftiu, kryetare, tha se ajo që e ka vonuar çështjen e diagnostifikimit, ka qenë se pacientët në vitet e mëhershme, janë ndalur në spitalet e përgjithshme, në repartet infektive dhe doza e gjakut e cila është marrë për analiza është dërguar në Institut. Në këtë vit ka ndodhur e kundërta, nëse është dyshuar që ka pacient me grip, atëherë është dërguar pacienti në QKUK.

Ajo theksoi se është shumë më lehtë që të dërgohet doza, gjegjësisht mostra e gjakut dhe të trajtohet në spitalet regjionale. Për atë janë spitalet e përgjithshme, sepse kanë repartet infektive dhe kanë mjekë të cilët janë të specializuar në infektive. Në këtë mënyrë është mbingarkuar Qendra Klinike Infektive me pacientë.

Naser Rugova, tha se edhe ai ka vërejtje sa i përket formulimit të raportit, i cili i është dërguar Komisionit Parlamentar, pasi që jemi institucione nacionale dhe Qendra Klinike Universitare është institucioni më i lartë i nivelit terciar. Kjo gjendje tregon një çakordim të plotë mes hallkave të sistemit, jo vetëm në sistemin terciar, por edhe në atë sekondar dhe primar, pasi që pacienti shkon në adresën e parë, gjegjësisht në Qendrën e Mjekësisë Familjare. Humbje të tilla të jetëve, e sidomos të personelit shëndetësorë për shtetin e Kosovës janë shumë. Mbi 14.000 punëtorë shëndetësorë duhet të mbrohen nga virusi, pasi që ata janë në frontin e parë me të infektuarit, të cilët kanë virusin vdekjeprurës të gripit sezonal.

Sipas tij, duhet të vaksinohen jo vetëm punëtorët shëndetësorë, mirëpo edhe administrata dhe jo vetëm me vaksinë kundër gripit, por edhe kundër hepatitit, pasi që një kontakt i punëtorit shëndetësor me gjakun e infektuar të pacientit shkakton vdekje.

Në vendet me sistem shëndetësor normal pretendohet të ekzistojnë stoqe me diku 10% e dozës së Tamiflu-së për numrin e popullatës rezidente në atë vend në rastet e epidemive të tilla. Ai tha se kjo duhet të jetë mësim nga një pësim shumë serioz, sepse ai konsideron si absurd vdekjen nga gripi në shekullin XXI.

Rugova shprehu shqetësimin jo vetëm për sistemin shëndetësor, mirëpo edhe për hallkat tjera. Ai theksoi se duhet të thirret bordi i SHSKUK-së, drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik si dhe drejtori i Klinikës Infektive, pasi që sa herë që po ndodhin këto fatkeqësi, nuk jemi të strukturuar si institucione shtetërore të përballemi me to. Ai po ashtu, tha se planifikimi për t'u marrë masat e nevojshme duhet të merret para tetorit.

Time Kadrijaj, theksoi se duhet të merremi me këto tema, pasi që vërtetë janë shqetësuese dhe si detyrë e Komisionit duhet të jetë ngritja e këtyre çështjeve dhe po ashtu është me vend kërkimi i një raporti, i cili shpjegon arsyen dhe rrugën deri te këto vdekje të cilat kanë ndodhur. Ajo

theksoi se duhet të ketë një bashkëpunim mes tri niveleve të shërbimit shëndetësor, gjegjësisht atij primar, sekondar dhe terciar, pasi që ka raste që fillimisht trajtohen në nivelin primar, më pas raportohen apo sugjerohen që të shkojnë në nivelin sekondar, e më pas në atë terciar dhe po ashtu, shprehu shqetësim për mungesën e Tamiflu-së.

Time Kadrijaj, nuk u pajtua me deputetin Haxhi Avdyli, për mënyrën se si i quajti të padijshëm mjekët, të cilët kanë hartuar raportin, që sipas saj janë profesionistë. Ajo u pajtua vetëm në aspektin e keqmenaxhimit, mirëpo, theksoi se termi i padijshëm është fyes për mjekët.

Haxhi Avdyli, tha se jo vetëm që janë njerëz të padijshëm, mirëpo edhe të përgjumur, pasi që ata paguhën nga taksat e qytetarëve të Kosovës për të kryer shërbimet e tyre, gjegjësisht të parandalojnë këto epidemi. Ai theksoi se detyra e vetme e Instituteve Kombëtare të Shëndetit Publik është të merren me epidemi dhe parandalimin e tyre. Sipas tij kjo duhet të jetë mësim për një mobilizim të mirëfilltë si në vaksinim, po ashtu, edhe në barnat antivirale.

Time Kadrijaj, në replikën e saj tha se pajtohet që menaxhimi nuk është efikas, mirëpo, është fyesë që profesionistëve shëndetësorë t'u thuhet të padijshëm, pasi që janë nivel akademik.

Flora Brovina, tha se është shqetësuese që gripi në këtë shekull të marrë kaq shumë jetë njerëzish. Sipas saj roli i Institutit të Shëndetit Publik duhet të jetë ndryshe, pasi që çdo rast duhet të paralajmërohet sepse mund të rrezikohet nga gripi. Ajo theksoi se Kosova nuk është oazë e izoluar, prandaj nuk duhet të çuditet sa i përket gripit, pasi që ai ndodhet në Evropë, rajon dhe kudo rreth nesh, prandaj duhet të merren masa parandaluese.

Brovina tha se kësaj teme i mungon përfaqësuesi i informacionit dhe se nuk mjafton vetëm raportin. Ajo e konsideron si të panevojshme grumbullimin e pacientëve prej qyteteve tjera në Prishtinë, pasi që menaxhimi do të jetë me efikas kur ka më pak pacientë. Ajo kërkoi që përfaqësuesit e Institutit të jenë prezent, në mënyrë që t'ua parashtrojë disa pyetje dhe po ashtu të konfirmojë saktësinë e statistikave të raportit.

Kryetarja, tha se është shumë i rëndësishëm takimi me drejtorin e SHSKUK-së dhe me drejtorin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë, në mënyrë që për vitin e ardhshëm të jemi më të përgatitur dhe të japim rekomandimet tona.

Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, theksoi se kjo temë është shumë e rëndësishme në mënyrë që të shohim se çfarë po bëjmë për preventivë. Sipas saj institutet janë të lëna anash. Ajo tha, se epidemiologët me muaj përpara fillojnë raportimin e gripit, mirëpo problemi qëndron tek logjistika. Epidemiologët janë njerëz të terrenit, prandaj e shprehi shqetësimin e saj se Epidemiologjia nuk kanë vetura me të cilat mund të kryhen punët në terren. Sipas saj problem kyç është të kuptojmë se sa investojmë në preventivë, apo në kuadër dhe në krijimin e kushteve të punës, ku epidemiologët të kenë të gjitha pajisjet mbrojtëse. Sipas saj, nuk varet gjithçka nga

diagnostifikimi, pasi që trajtimi mund të fillojë edhe me pasqyrë klinike, pra nuk është e nevojshme që secili rast të trajtohet në bazë të mostrave të gjakut.

Ajo tha se raportimi bëhet në bazë të ILI, ARI, SARI, ku ILI përfshin gripet e rëndomta, ndërsa ARI dhe SARI kanë sindromet respiratorë dhe të gjithë mjekët janë të trajnuar për të vërejtur nëse një grip mund të shkojë në faza të komplikimit. Nuk është problemi që nuk ka sistem, mirëpo, problemi qëndron tek raportimi, ku ende raportohet në hard copy, pra ka mungesë të mjeteve të punës, pasi që duhet të bëhet raportimi ditor dhe javor. Ligji për sëmundje është shumë recidiv. Ka ndëshkime shumë të mëdha, jo vetëm për mjekun i cili nuk raporton, por edhe për drejtorin dhe institucionin në fjalë, pra ndëshkimi shkon në tri nivele. Ne si komision duhet të përkrahim preventivën dhe institucionet.

Drita Millaku, tha se politikat shëndetësore dhe shëndetësia janë në gjendje të rëndë. Çfarë po ndërmerr Instituti në raste të parandalimit të epidemive, njësoj siç ka qenë epidemia e rriqrave në rajonin e Malishevës. Ajo theksoi se edhe pse mjekët kanë rroga, atyre u mungojnë kushtet elementare të punës. Pastaj, duhet të bëhen strategji, për këtë arsye ekzistojnë politikat e shëndetësisë në mënyrë që të ndërmerren masat para se të ndodhë rasti, sepse është shqetësuese që 13 raste të humbin jetën nga gripin në këtë shekull. Komisioni duhet të bëjë trysni më shumë tek Ministria e Shëndetësisë dhe tek institucionet kompetente, në mënyrë që raste të tilla mos të ndodhin më në Republikën e Kosovës.

Bekim Haxhiu, tha se ne kemi kërkuar raport, dhe atë e kemi marrë në mënyrë të detajuar. Po ashtu shprehi kënaqësi që u ngrit tema të cilën ai që nga viti 2011 e ngrit në seanca parlamentare për mungesën e funksionimit të Sistemit të Informimit Shëndetësor, për të cilin përgjegjës janë ministrat dhe drejtorët e drejtorive të shëndetësisë në të gjithë komunat, pa përjashtim.

Kur jemi tek rastet e epidemive dhe ajo e kalon 20% të popullatës, atëherë duhet të përdoren mekanizma të tjerë për parandalimin e epidemisë. Është shqetësuese vdekja e 13 pacientëve për shkak të një gripin dhe kjo e saktëson faktin se sa i brishtë është sistemi shëndetësor. Përderisa kemi këtë mendësi të organizimit shëndetësor, është problematike, pasi që 80% e shërbimeve merren në Qendrën Klinike Universitare në sektorin terciar, e 20% merren në atë primar dhe sekondar. Sipas tij, ky nuk është raport i përgjithshëm, pasi që mungojnë raportimet nga klinikat private. Haxhiu theksoi se sot Kosova më së shumti investon në sëmundjet kardiovaskulare dhe sëmundjet e kancerit, ku tek sëmundjet kardiovaskulare zakonisht preken popullata e moshuar. Nëse i shikojmë buxhetet e planifikuara të viteve të kaluara, ato pasqyrojnë në mënyrë reale gjendjen e tanishme. Prishtina ka mungesë të hallkës kryesore të sistemit shëndetësor, sepse rajoni i Prishtinës në tërësi nuk e ka spitalin rajonal tash e 21 vite, ku qytetarët e Prishtinës, Podujevës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Drenasit dhe Lipjanit, prej sektorit primar kalojnë drejt në atë terciar. Ai theksoi se duhet të krijohen sisteme dhe këto sisteme duhet t'i bëjmë së bashku.

Enver Hoti, tha se informata e cila është dërguar në bazë të kërkesës është e plotë dhe kjo është gjendja në të cilën ndodhemi, dhe si pasojë ka vërejtje në menaxhimin e gripit sezonal. Ai

mbështeti kolegët parafolës, duke theksuar se është shqetësuese mungesa e preventivës, gjegjësisht vaksinave dhe Tamiflu-së, pasi që masat mbrojtëse është dashur të merren me kohë. Ai shprehu shqetësimin e tij nga kalkulimet dhe tentativat e mediave për të manipuluar dhe për të etabluar diçka që është në një funksion normal, por sipas tij ajo duhet të mbetet në ndërgjegjen e mediave.

Hoti tha se sistemi i shëndetësisë nuk është funksional dhe vërehet mungesa e informacionit dhe nuk po shfrytëzohen as kapacitetet aktuale që i ka ky sistem. Ne duhet të jemi të fokusuar dhe të preokupuar si Komision në politikat shëndetësore, të cilat do të kenë një çasje adekuate për ndryshimin dhe funksionimin e këtij sistemi.

4. Informata rreth themelimit të Këshillit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm;

Besa Baftiu, kryetare, tha se Komisioni është bartës apo iniciues i Rezolutës për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, e cila është votuar njëzëri nga të gjitha subjektet politike, të cilat janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më 25.1.2018. Pas miratimit të Rezolutës në Kuvend, më 5 qershor, është mbajtur takimi i parë iniciues për themelimin e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm si një grup joformal i Kuvendit, grup i cili do të merret me monitorimin e zbatimit të Rezolutës. Më 10 tetor është mbajtur takimi i dytë, ku është aprovuar akti themelues i Këshillit dhe në fillim të këtij muaji, Kryesia e Kuvendit ka aprovuar kërkesën e themelimit të Këshillit në përputhshmëri me Rezolutën dhe aktin themelues. Ky Këshill do të ketë strukturë ndërinstitucionale, që do të udhëhiqet nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Më 15 shtator, në Ditën e Demokracisë, në oborrin e Kuvendit është vendosur instilacioni që ende është aty dhe që simbolizon aderimin e Kosovës dhe bashkëngjitjen tonë në vende të tjera të botës për realizimin e kësaj agjende. Ajo theksoi se në javën e kaluar Kryetari i Kuvendit ka nënshkruar vendimin për themelimin e këtij Këshilli me këtë përbërje: kryetarja dhe anëtarët e Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, kryetarët e Komisioneve Parlamentare të Kuvendit, deputetë të interesuar në proceset e objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit dhe përfaqësues të grupit të grave dhe grupeve të tjera joformale. Po ashtu, pjesë e këtij Këshilli mund të jenë edhe anëtarët e jashtëm, përfaqësues nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit, përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit, përfaqësues nga institucioni i Presidentit të Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, përfaqësues të anëtarëve të ekipit të Kombeve të Bashkuara.

5. Të ndryshme.

Besa Baftiu, kryetare, diskutoi rreth projektligjeve të cilat janë në draftim dhe caktimi i datës, kur Komisioni do të punojë rreth Projektligjit për Inspektorat të Punës. Është diskutuar edhe për

Projektligjin e Këshillit Ekonomik Social dhe vizita dyditore në Shqipëri, për të punuar në mënyrë sistematike rreth KES-it.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15

E përgaditi:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Besa BAFTIU